



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT
AGJENCIA KOMBËTARE E KËRKIMIT SHKENCOR DHE INOVACIONIT
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 44213 Prot.

Tiranë, më 06/04/2022

VENDIM

Nr. 3, datë 06.04.2022

PËR

Miratimin e financimit të Projekteve të Infrastrukturës së Kërkimit Shkencor, miratuar me Vendim të BA Nr.1, Datë 01.10.2021, “Për miratimin e financimit të projekteve fituese të kërkimit shkencor për vitin 2021”, të cilat nuk kanë arritur t’i përfundojnë procedurat e prokurimit gjatë vitit 2021.

Mbështetur në Ligjin Nr. 80/2015, “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, Ligjin Nr. 8480, datë 27.05.1999, “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike”, VKM Nr. 607, datë 31.08.2016, “Për krijimin, përbërjen, organizimin dhe funksionimin e Agjencisë Kombëtare të Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit (AKKSHI)”, VKM Nr.75, datë 12.08.2018, “Për miratimin e modelit të financimit të institucioneve publike të arsimit të lartë dhe kërkimit shkencor” dhe Urdhërit nr.10, datë 15.01.2021, “Për ngritjen e Bordit të Administrimit të Agjencisë Kombëtare të Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit (AKKSHI)”, Bordi i Administrimit të AKKSHI-së, në mbledhjen e datës 06.04.2022,

VENDOSI:

1. Miratimin e financimit të Projekteve të Infrastrukturës së Kërkimit Shkencor, miratuar me Vendim të BA Nr.1, Datë 01.10.2021, “Për miratimin e financimit të projekteve fituese të kërkimit shkencor për vitin 2021”, të cilat nuk kanë arritur t’i përfundojnë procedurat e prokurimit gjatë vitit 2021, sipas tabelës bashkëlidhur.
2. Ngarkohet AKKSHI për zbatimin e këtij vendimi.

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

BORDI I ADMINISTRIMIT

Znj. Evis KUSHI Kryetar

Z.Skender TOPI

Anëtar

Znj.Zamira GJINI Anëtar

Znj. Ines MUÇOSTEPA Anëtar

Znj. Eva BICA Anëtar

Z. Vasil S. TOLE Anëtar

Nr.	Titulli i Projektit	IAL	Fusha	Vlera e kontrates
1	Ngritja e Labororit për Vlerësimin e Cilësisë së Ujërave (LVCU) pranë Universitetit Bujqësor të Tiranës	Universiteti i Bujqësor i Tiranës	Biodiversiteti dhe Mjedisi	10.604.035
2	Ristrukturimi i kapaciteteve kërkimore të Departamentit të energjisë në fushën e dekarbonizimit të ekonomisë. (Green Economy)	Universiteti Politeknik i Tiranës	Uji dhe Energjia	34.337.032
3	Ngritja e Labororit të Teknologjisë dhe Cilësisë së Frutave dhe Perimeve	Universiteti i Bujqësor i Tiranës	Agrikulturë, Ushqim dhe Bioteknologji	4.973.253
4	Laboratori i Analizave të Ushqimeve	Universiteti "L. Gurakuqi", Shkodër	Agrikulturë, Ushqim dhe Bioteknologji	10.000.000
5	Ndertimi i nje laboratorit per kerkim shkencor ne funksion te studimeve te doktoratures, prane Fakultetit te Biznesit UAMD	Universiteti "A. Moisiu", Durres (UAMD)	Shkenca Sociale dhe Albanologjike	10.000.000
6	Dixhitalizimi i burimeve bibliotekare në Universitetin e Elbasanit "Aleksandër Xhuvani"	Universiteti "A.Xhuvani", Elbasan	Sisteme dhe Teknologji Informacioni	25.000.000
7	Dixhitalizimi i fondit të Bibliotekës së Universitetit "Fan S. Noli", me fokus aksesin në kohë reale nga kërkuesit dhe studentët në nivel institucional dhe ndërinstucional .	Universiteti " Fan S. Noli", Korçë	Sisteme dhe Teknologji Informacioni	14.000.000

BORDI I ADMINISTRIMIT

Znj. Evis KUSHI Kryetar

Z. Skender TOPI Anëtar

Znj. Zamira GJINI Anëtar

Znj. Ines MUÇOSTEPA Anëtar

Znj. Eva BICA Anëtar

Z. Vasil S. TOLE Anëtar